

VENDIM
Nr.276, datë 18.3.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS QENDËR BULGAREC, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Qendër Bulgarec të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 412 (katërqind e dymbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër Bulgarec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qendër Bulgarec

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4-30	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
58-70	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
85-102	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile.	Në pronësi
1,2,3,31-54	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive.	Në pronësi
103-116	Shërbim funeral	Në pronësi
182,186,187,189-217	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, troje të zëna) dhe shërbime publike	Në pronësi
71-81	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës. Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji	Në përdorim
325,326,329,331,333,336,338, 340,341,342,344,345,346,348,349,350	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
229,253,277,285,295,302,312,315,320, 327,328,330,332,334,335,337,339,343,347	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
351-363	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi